

PROJEKTI:
“PËRDORIMI I TË DHËNAVE
PËR PRONARËT E VËRTETË PËR
TË REDUKTUAR KORRUPSIONIN”

ANALIZË

Shkup, dhjetor 2024



për përdorimin e të dhënave për
pronarët e vërtetë në luftën kundër
korrupsionit në Maqedoninë e Veriut



“Analiza për përdorimin e të dhënave për pronarët e vërtetë në luftën kundër korrupsionit në Maqedoninë e Veriut”

Botues: Qendra për Komunikim Qytetare

Autorë: German Fillkov, Pavle Gatsov, Sabina Fakiq, Aleksandar Janev

Ekipi i hulumtuesve: Pavlinka Strezoska, Marko Mitevski

Përktheu nga gjuha maqedonase në gjuhën shqipe: Agon Ismaili

Dizajni grafik: Polyesterday - Shkup

Printoi: Polyesterday - Shkup

Tirazh: 150

Tirazh falas/jokomercial

CIP - Каталогизација во публикација
Национална и универзитетска библиотека "Св. Климент Охридски", Скопје

343.85:343.352]:347.23(497.7)(047.31)

АНАЛИЗА на користењето на податоците за вистинските сопственици во борбата против корупцијата во Северна Македонија / [автори Герман Филков ... [и др.] : [përktheu nga gjuha maqedonase në gjuhën shqipe Agon Ismaili]. - Скопје : Центар за граѓански комуникации, 2024. - 54 стр. : 29 см

Текст на мак. и алб. јазик. - Фусноти кон текстот. - Други автори: Павле Гацов, Сабина Факиќ, Александар Јанев. - Содржи и: *Analizë për përdorimin e të dhënave për pronarët e vërtetë në lu ën kundër korrupsionit në Maqedoninë e Veriut.* - Публикацијата е во рамки на проектот: "Користење на податоците за вистински сопственици за намалување на корупцијата"

ISBN 978-608-4974-42-0

1. Филков, Герман [автор] 2. Гацов, Павле [автор] 3. Факиќ, Сабина [автор] 4. Јанев, Александар [автор]
а) Корупција -- Спечување -- Вистински сопственици -- Користење на податоци -- Македонија -- Истражувања

COBISS.MK-ID 64974085

Përmbajtja

Përmbledhje e analizës për Maqedoninë e Veriut.....	31
Përmbledhje e analizës mbi gjendjen në nivel botëror.....	32
Konteksti.....	33
Pse dhe si ndodhi publikimi i të dhënave për pronarët e vërtetë?.....	34
Zbatimi i transparencës për pronarët e vërtetë.....	36
Themelimi i një regjistri për pronarët e vërtetë në vendin tonë.....	40
Përdorimi i të dhënave për pronarët e vërtetë në parandalimin e pastrimit të parave dhe financimit të terrorizmit dhe në luftën kundër korrupsionit.....	43
(Mos)zbatimi i masave të rekomanduara nga FMN-ja dhe të parashikuara në planin e veprimit për Partneritetin për Qeverisje të Hapur.....	51
Rekomandimet.....	53
Linqet për materialet dhe literaturën referente.....	54

Përmbledhje e analizës për Maqedoninë e Veriut

- Në Maqedoninë e Veriut, Regjistri i pronarëve të vërtetë u lëshua në përdorim në **janar të vitit 2021**, ndërsa të dhënat nga ky regjister janë në dispozicion nga prilli i vitit 2021 e këndej.
- Institucionet kompetente të vendit, në përgjithësi pak i përdorin të dhënat për pronarët e vërtetë për të parandaluar, zbuluar dhe sanksionuar pastrimin e parave dhe për luftë kundër terrorizmit, ndërkaq duket se aspak nuk i përdorin për qëllime të tjera dhe për të parandaluar korrupsionin, krimin dhe abuzimet në fusha të tjera.
- Institucionet dhe Drejtoria kompetente për Inteligjencë Financiare kanë **të dhëna të ndryshme** për numrin e rasteve kundër pastrimit të parave dhe financimit të terrorizmit.
- Nga viti 2022 deri në prill të vitit 2024, në Drejtorinë **janë parashtruar 194 iniciativa** nga organet kompetente, nga të cilat, Drejtoria ka përgatitur dhe ka **paraqitur 21 raport** në Prokurorinë Publike Themelore për Ndjekjen e Krimit të Organizuar dhe Korrupsionit. Gjithashtu, në të njëjtën periudhë, në këtë prokurori, nga ana e Drejtorisë janë paraqitur 50 raportime për transaksione të dyshimta, me iniciativë të saj.
- Nga gjithsej 71 raport që Drejtoria i ka paraqitur në Prokurorinë, **70% janë me iniciativë të saj**, ndërsa pjesa tjetër 30% janë bazuar në iniciativë të parashtruar më parë nga ndonjë prej institucioneve kompetente.
- Nga 17 institucionet në vend me të cilat Drejtoria duhet të bashkëpunojë, ndërsa prej tyre, për tetë është cekur drejtpërdrejtë në ligj se duhet të luftojnë pastrimin e parave dhe financimin e terrorizmit, **vetëm dy nga këto kanë shifra konkrete për rastet** për të cilat kanë përdorur të dhëna nga Regjistri për pronarët e vërtetë.
- Maqedonia e Veriut **nuk e merr përsipër obligimin e rekomanduar** nga FMN-ja gjatë krizës së COVID-19 – për t'i publikuar emrat e pronarëve të vërtetë të kompanive që kanë nënshkruar kontrata për prokurime publike lidhur me korona-krizën.
- Vendi **nuk e ka përmbushur as angazhimin** nga Planit Nacional i Veprimit për Partneritet për Qeverisje të Hapur 2021-2023 për t'i bërë të ditur për publikun pronarët e vërtetë të firmave ofertuese dhe të atyre që kanë fituar kontratë për prokurime publike.
- Edhe Bashkimi Evropian edhe OSBE-ja kanë vërejtje për sa i përket përdorimit të pamjaftueshëm të të dhënave nga regjistri për pronarët e vërtetë.
- Për ta përmirësuar përdorimin e të dhënave për pronarët e vërtetë në shtet, **rekomandimet janë**: të zgjerohet përfshirja e pronarëve të vërtetë, lehtësimi i qasjes tek të dhënat për një numër më të madh palësh të interesuara, lidhja me baza dhe të dhëna tjera, shkallë me madhe interoperativiteti ndërmjet institucioneve dhe përmirësim i verifikimit të të dhënave.

Përmbledhje e analizës mbi gjendjen në nivel botëror

- Bota ka filluar më gjerësisht t'i afirmojë problemet me pronësinë e fshehur mbi kompanitë, veçanërisht pas disa skandaleve si “Panama dokumentet”, “Paradajsk dokumentet” dhe “Pandora dokumentet”, të cilat zbuluan se individë në poste publike kanë abuzuar me pozitat e tyre për përfitimin e kompanive që ata ose bashkëpunëtorët e tyre të ngushtë i zotërojnë dhe i kontrollojnë fshehurazi.
- Kjo ka bërë që shumë vende të themelojnë dhe publikojnë regjistra të pronarëve të vërtetë të kompanive, përkundër pronarëve formalë ose ligjorë që janë të regjistruar në regjistrat e rregullt për kompani.
- “Pronari i vërtetë” është një person fizik, i cili në esencë e zotëron ose kontrollon kompaninë ose pronën dhe mjetet e asaj kompanie, apo person i cili ka përfitim material nga prona/mjetet e asaj kompanie.
- Në shumicën e vendeve, si pronësi e vërtetë konsiderohet: pronësia faktike, të drejtat e votës, të drejtat për benefite dhe të drejtat për t'i emëruar ose shkarkuar anëtarët e bordeve të drejtorëve.
- Në shumicën e vendeve që kanë themeluar grumbullim të informacioneve për pronarët e vërtetë, limiti është “të paktën” ose “më tepër se” 25%, por ka vende që vendosin limite më të ulëta sikur 20%, 10%, madje edhe vende ku ka nuk ka një limit të tillë.
- Sipas të dhënave më të fundit, 97 vende kanë miratuar zgjidhje ligjore për regjistrimin formal të pronësisë së vërtetë të kompanive.
- Informacionet për pronarët e vërtetë përdoren për të parandaluar, zbuluar dhe sanksionuar pastrimin e parave, financimin e terrorizmit, korrupsionin dhe abuzimet e tjera të fondeve publike në prokurimet publike, subvencionet, ndihmën shtetërore, koncesionet, pagesat e taksave, donacionet partiake, financimin e fushatave politike, etj.

Konteksti

Korrupsioni i përhapur në vend, përkundër rasteve të pakta gjyqësore, krijon pasiguri, e dobëson besimin e qytetarëve në sektorin publik, e pengon zhvillimin ekonomik dhe kërcënon sundimin së drejtës. Për herë të parë pas mëvetësimit të shtetit, qytetarët konsiderojnë se korrupsioni paraqet problem thelbësor shoqëror, madje edhe më i madh se problemet e natyrës ekzistenciale sikur papunësia, çmimet e larta dhe të ardhurat e ulëta. Mirëpo, në vend të rezultateve konkrete në luftën kundër korrupsionit, vitet e fundit, nën ndikimin e tendencave aktuale për parandalim të korrupsionit, në vazhdimësi po ndryshohen normat, po miratohen plane, strategji dhe vegla të reja. Nga ana tjetër, përpjekjet për zbatimin e duhur të tyre janë të pamjaftueshme, gjë që rezultojnë në mungesën e rezultateve më të mëdha në luftën kundër korrupsionit.

Kështu, me qëllim të harmonizimit me standardet ndërkombëtare dhe të BE-së për luftimin e pastrimit të parave dhe financimit të terrorizmit, në vitin 2021 u pranua iniciativa për themelimin e një Regjistri për pronarët e vërtetë. Megjithatë, për dallim nga vendet tjera, në vendin tonë ky regjistër ende nuk po e përmbush plotësisht funksionin e tij dhe nuk ka efekte të rëndësishme nga themelimi i tij në drejtim të rritjes së transparencës për strukturat pronësore të kompanive dhe përdorimit të këtyre informacioneve në luftën kundër korrupsionit dhe parandalimin e transaksioneve të paligjshme financiare.

Së këtejmi, me rëndësi thelbësore është monitorimi objektiv dhe i paanshëm mbi përdorimin faktik të informacioneve të këtij regjistri nga ana e institucioneve kompetente për luftë kundër korrupsionit, nga organet ligjzbatuese dhe prokuroritë. Gjithashtu, në luftën kundër korrupsionit nevojitet një kryqëzim i të dhënave nga ky regjistër me regjistrat e tjerë dhe të dhënat me të cilat menaxhojnë disa prej këtyre institucioneve.

Mungesa e presionit publik mund të rezultojë me përdorim joadekuat të regjistrat dhe me reduktimin e ekzistencës së atij regjistri në një formalitet që nuk do të krijojë asnjë efekt pozitiv për sa u përket rezultateve të dëshiruara kundër korrupsionit.

Gjithashtu, është jashtëzakonisht e rëndësishme që informacionet për pronarët e vërtetë të përdoren edhe për reduktimin e korrupsionit dhe keqpërdorimeve në prokurimet publike, nëpërmjet të cilave shpenzohen më tepër se 1 miliard euro në nivel vjetor. Me iniciativë të QKQ-së, Planit Nacional i Veprimit për Partneritetin për Qeverisje të Hapur 2021-2023 përfshinte angazhimin për publikimin e pronarëve të vërtetë të kompanive që kanë fituar në tenderët shtetërorë, ndërsa teksti i ri i Planit Nacional të Veprimit për PQH 2024-2026 përmban një angazhim të zgjeruar – publikimin e emrave të pronarëve të vërtetë të kompanive që kanë fituar kontrata për prokurime publike, për koncesione dhe për themelimin të partneritetit publiko-privat.

Duke pasur parasysh se është shumë e pasigurt nëse dhe kur do të realizohet ky angazhim, jashtëzakonisht e rëndësishme është që në ndërkohë të kryqëzohen, kontrollohen dhe analizohen të dhënat e këtyra në mënyrë retroaktive, për periudhën që kur ka ekzistuar regjistri, me qëllim që të zbulohet nëse ka pasur konflikt interesash dhe abuzime me pushtetin nga figurat politike në lidhje me prokurimet publike, si një fushë e cila është më e ekspozuara ndaj korrupsionit. Ndërkohë, kjo analizë është përgatitur për të vlerësuar përvojën e deritanishme me përdorimin e të dhënave nga Regjistri për pronarët e vërtetë në luftën kundër korrupsionit, për t'i zbuluar mangësitë dhe dobësitë si dhe për të identifikuar hapësirën për përmirësim.

Pse dhe si ndodhi publikimi i të dhënave për pronarët e vërtetë?

Duket sikur gjithçka ka filluar nga të ashtuquajturat kompani “shell” (guaskë) (që janë kompani “boshe”, kurse të cilat janë vetëm të regjistruara, pa të punësuar dhe në të shumtën e rasteve shërbejnë për të pompuar para nëpërmjet shërbimeve këshillëdhënëse, përkatësisht për të transferuar para për shërbime fiktive nga njëra “kompani boshe” në tjetër “kompani boshe” me qëllim që të vështirësohet gjurmueshmëria e tyre). Këto kompani më së shpeshti përdoren për t'i fshehur profitet, për të financuar terrorizmin ose për fshehjen e parave të fituara në mënyrë të paligjshme. Në të njëjtën kohë, në shumicën e vendeve, nuk ka qenë e nevojshme të publikohen të dhënat për individin(ët) që realisht ka(në) kontrollin ose përfitojnë nga biznesi (“pronarët e vërtetë”).

Bota filloi më gjerësisht t'i afirmojë këto probleme, veçanërisht pas disa skandaleve të zbuluara me zbardhjen e “Panama dokumenteve” (Panama papers) në vitin 2016, “Paradajsk dokumentet” (Paradise papers) në vitin 2017 dhe “Pandora dokumentet” (Pandora papers) në vitin 2021, me çka u përshpejtua interesi për reformë në transparencën për pronësinë e vërtetë. Kjo ndikoi që shumë vende, në mënyrë vullnetare, e më pas me ligje dhe akte tjera të themelojnë dhe të publikojnë regjistra për pronarët e vërtetë.

Kështu, në vitin 2016, me zbulimin e rastit të ashtuquajtur “Panama Papers” është ekspozuar që më tepër se 140 zyrtarë kanë fshehur pronësinë e tyre në më tepër se 214,000 ‘offshore’ kompani. Edhe rastet e ashtuquajtura “Pandora Papers” që vijuan në vitin 2021 kanë zbuluar ‘offshore’ llogaritë e më tepër se 30 liderëve botërorë, krerëve të shteteve, funksionarëve dhe politikanëve të tjerë. Më herët, Banka Botërore ka dhënë vlerësimin se përafërsisht në 70% të rasteve më të mëdha të korrupsionit në botë, në periudhën ndërmjet viteve 1980 dhe 2010, të involvuara kanë qenë kompani anonime.¹


Ishte e qartë që pas velit të fshehtësisë ndodhin keqpërdorime dhe korrupsion. Kjo donë të thotë që individë në poste publike abuzojnë me ato pozicione në favor të kompanive që ata ose bashkëpunëtorët e tyre të ngushtë i zotërojnë dhe kontrollojnë fshehurazi. Së këtejmi, rezultoi nevoja për të ditur se cilët konkretisht janë personat që zotërojnë, kontrollojnë dhe përfitojnë nga kompanitë – në mënyrë që të parandalohen dhe zbulohen abuzimet. Në këtë mënyrë është krijuar shprehja “pronarë të vërtetë”, në krahasim me pronarët zyrtarë apo të ligjshëm që janë të regjistruar në regjistrat e zakonshëm për kompani.

Në kuptimin më të gjerë, shprehja “pronar i vërtetë” nënkupton një person fizik, i cili në esencë e ka në zotërim kompaninë ose kontroll mbi kompaninë apo mbi pronën dhe mjetet e saj, ose person që ka përfitim material nga prona/mjetet e asaj kompanie. Kontrolli në këtë kuptim mund të ushtrohet drejtpërsëdrejti ose tërthorazi, përmes ndërmjetësve dhe formave tjera të marrëveshjeve. Kontrolli mbi kompaninë ushtrohet nëpërmjet zotërimit të pasurisë ose të një pjese të konsiderueshme të të drejtave të votës që mundësojnë ndikim në emërimin e drejtorëve, zotërimin e aksioneve “të arta”, etj.

Për dallim nga pronari i vërtetë, pronari ligjor, ose organi drejtues, është ai që mban një funksion ligjor. Në shumë raste, pronari ligjor dhe pronari i vërtetë është i njëjti person, posaçërisht në firmat dhe bizneset më të vogla, si dhe në shoqatat. Por në rastet kur pronari i vërtetë është i fshehur, pronari ligjor që është i regjistruar në regjistrin për kompanitë, në kadastrën e pasurive të paluajtshme, në llogaritë bankare, nuk është personi i cili është pronari i vërtetë.

¹ Van der Does de Willebois, Emile, Emily M. Halter Robert A. Harrison Ji Won Park JC Sharman, Mjeshtrit e Kukullave, Si të korruptuarit i përdorin strukturat ligjore për të fshehur pasuritë e vjedhura dhe çfarë të bëhet për këtë, Banka Botërore, 2011 (<https://star.worldbank.org/sites/star/files/puppetmastersv1.pdf>)

Limiti minimal i interesit pronësor për pronarët e vërtetë është i ndryshëm në vende dhe rajone të ndryshme të botës. Në Bashkimin Evropian, ky limit është përcaktuar në 25%, ndërsa në vendet e tjera të botës që kanë përcaktuar një limit të tillë, përqindja dallon nga 5% deri në 20%, madje edhe publikim i detyrueshëm i pronarit të vërtetë pa çfarëdo niveli minimal të limitit.



Me kalimin e kohës, transparenca për pronësinë e vërtetë është bërë një nga veglat më të rëndësishme botërore për trajtimin e transaksioneve të paligjshme financiare që ndërlidhen me evazionin fiskal, pastrimin e parave, korrupsionin dhe financimin e terrorizmit.

² Të dhënat për pronësinë e vërtetë në prokurimet, Pronësia e hapur, 2021

Zbatimi i transparencës për pronarët e vërtetë

Zbatimi i një shkalle më të gjerë të publikimit të informacioneve për pronarët e vërtetë është mundësuar dhe inkurajohej veçanërisht përmes të ashtuquajturit ndërkombëtarizim i kësaj çështjeje. Për këtë kontribut të madh ka pasur FATF³, përkatësisht Task Forca për Veprim Financiar, i cili është organi i parë ndërkombëtar që në vitin 2003 i publikoi standardet ndërkombëtare për pronësinë reale, ndërsa më vonë, përkatësisht në 2012 u reviduan.

Më pas, në vitin 2014, Grupi i Punës për Anti-Korrupsion i G-20 miratoi Parimet e nivelit të lartë për transparencën e pronësisë reale.

Në vitin 2017, Bashkimi Evropian e miratoi Direktivën e Pestë Kundër Pastrimit të Parave, e cila i obligoi shtetet-anëtare të grumbullojnë dhe publikojnë informacione për pronarët e vërtetë të kompanive të regjistruara më së voni deri në vitin 2020.

Ndërkohë, u formua edhe Grupi i Liderit për pronarët e vërtetë⁴, i cili synon të mbështesë zbatimin e transparencës për pronësinë reale. Grupi përbëhet nga Armenia, Kenia, Letonia, Meksiko, Nigeria, Norvegjia, Republika Sllovaqe dhe Mbretëria e Bashkuar. Secili vend nënshkruar zotohet për respektimin e disa parimeve për zbulimin e pronësisë reale, përkatësisht:

- Publikimi i të dhënave për pronësinë e vërtetë për kompanitë, të cilat lirshëm mund të shkarkohen, të kërkojnë dhe të përdoren sërish nga publiku, pa kompensim, softuer mbrojtës apo nevojë për t'u regjistruar.
- Zbatimi i praktikave më të mira ambicioze progresive në transparencën për pronësinë e vërtetë, nëpërmjet parametrave teknikë, ligjorë, rregullatorë dhe administrativë.
- Dedikimi i resurseve për të mundësuar përmirësime dhe për të ruajtur cilësinë dhe standardizimin e të dhënave.
- Të kontribuohet në ndërtimin e praktikave më të mira, duke përfshirë njohjen e kërcënimit në rritje të mjeteve financiare të paligjshme dhe të merret parasysh zbatimi i transparencës për pronësinë e vërtetë jashtë kompanive në një grup më të gjerë të llojeve të mjeteve.
- Punë në partneritet me shoqërinë qytetare dhe të mundësohet realizimi i rolit të tyre si vëzhgues dhe përdorues të të dhënave.
- Angazhimi i partnerëve të tjerë, duke përfshirë qeveritë dhe institucionet ndërkombëtare, për të avancuar synimin që transparenca për pronësinë e vërtetë të bëhet normë globale; dhe
- Kontribut në evaluimin dhe vlerësimin e ndikimit të qasjes së përbashkët.

³ Më shumë rreth FATF në linkun në vijim: <https://www.fatf-gafi.org/en/home.html>

⁴ Më shumë rreth grupit në linkun në vijim: <https://www.opengovpartnership.org/beneficial-ownership-leadership-group/>

Si rezultat i të gjitha këtyre përpjekjeve, rreth pesëdhjetë vende të botës kanë themeluar të ashtuquajturit regjistra për pronarët e vërtetë, ndërkaq edhe aq shtete kanë marrë përsipër obligimin për të bërë këtë në të ardhmen e afërt ose tashmë kanë filluar aktivitete të tilla.

Sipas të dhënave të fundit⁵, 97 vende kanë miratuar zgjidhje ligjore për regjistrimin formal të pronësisë së vërtetë të kompanive. Shumica prej tyre janë nga Evropa, përkatësisht 42 shtete, nga Amerika Latine 21 shtet, nga Azia 15 shtete, nga Afrika 12 shtete, nga Oqeania 5 dhe nga Amerika e Veriut 2 shtete.

Një “goditje” e madhe në këtë kuptim është shkaktuar nga vendimi i Gjykatës Evropiane të Drejtësisë në nëntor të vitit 2022, për shfuqizimin e dispozitave të Direktivës së Pestë të BE-së me të cilat është kërkuar qasje publike tek informacionet për pronësinë e vërtetë si një mjet për parandalimin dhe zbulimin e pastrimit të parave. Megjithatë, disa nga shtetet anëtare të BE-së kanë vendosur t'i lënë publike regjistrat e tyre për pronarët e vërtetë në favor të interesit dominues publik, ndërsa disa shtete tjera, që menjëherë i mbyllën regjistrat pas këtij vendimi gjyqësor, kanë filluar ndërkohë të sjellin vendime për “hapje” të sërishme. Ajo që është veçanërisht me rëndësi në këtë vendim gjyqësor është që në mënyrë eksplicite njihet “interesi legjitim” i mediave dhe organizatave të shoqërisë qytetare për të pasur qasje tek këto informacione lidhur me rolin e tyre në luftën kundër pastrimit të parave. Sot, në nivel të BE-së (edhe pse situata gjithnjë po ndryshon), më tepër se gjysma, përkatësisht 14 shtete anëtare⁶ kanë regjistra për pronarët e vërtetë dhe publiku ka qasje te këto regjistra (Franca, Portugalia, Danimarka, Suedia, Estonia, Letonia, Polonia, Republika Çeke, Sllovakia, Hungaria, Rumania, Bullgaria, Kroacia dhe Sllovenia). Në tre shtete, regjistri për pronarët e vërtetë është pezulluar, në Qipro, në Maltë dhe në Holandë. Në një shtet, në Greqi më konkretisht, regjistri është privat dhe për këtë arsye publiku nuk ka qasje, ndërsa në nëntë shtetet tjera anëtare (Gjermania, Irlanda, Spanja, Italia, Austria, Belgjika, Lituania, Luksemburgu dhe Finlanda), subjektet me interes legjitim kanë qasje në regjistrat përkatës.

Regjistrimi i pronarëve të vërtetë bëhet më së shpeshti në regjistrat zyrtarë të vendeve, por ka raste kur themelohen regjistra të posaçëm, ndërsa diku, kjo bëhet edhe në suazat e administratave tatimore.

Në shumicën e vendeve, në të të cilat kanë themeluar grumbullimin e informacioneve për pronarët e vërtetë, limiti është “të paktën” ose “më tepër se” 25%. Direktiva e pestë e lartpërmendur e BE-së, me të cilën gjithashtu përcaktohet ky limit, ka një ndikim të madh në vendet për përcaktimin e kësaj përqindjeje. Megjithatë, ka vende që përcaktojnë përqindje më të vogla, për shembull 20%, 10%, madje edhe vende ku nuk ka një përqindje të tillë. Në të njëjtën kohë, kjo përqindje shpesh varet nga elementi me të cilin përcaktohet pronari i vërtetë, përkatësisht varet nëse ky element është pronësia, e drejta e votës, e drejta për benefite apo e drejta për të përcaktimin e drejtorëve. Ka shumë raste kur ka limite të ndryshme për të drejta të ndryshme.

Shpesh, pronësia e drejtpërdrejtë individuale si tregues nuk është e mjaftueshme për të zbuluar pronësinë e vërtetë. Ekzistojnë kompani dhe forma të tjera komplekse shoqatash në të cilat, qëllimisht ose rastësisht, asnjë person nuk ka pronësi mbi limitin e përcaktuar, prandaj ka rezultuar si e domosdoshme të merren parasysh edhe tregues të tjerë. Kështu, në shumicën e vendeve, pronësia reale konsiderohet të jetë: pronësia faktike, të drejtat e votës, të drejtat për benefite dhe të drejtat për të emëruar ose shkarkuar anëtarë të bordeve të drejtorëve. Megjithatë, nuk ekziston një përqindje e njësuar e interesit pronësor, përkatësisht, i limitit mbi të cilin një person konsiderohet pronar i vërtetë.

⁵ Knobel, Andres dhe Florencia Lorenzo, [Regjistrimi i pronësisë së vërtetë në të gjithë botën 2022](#), Rrjeti i Drejtësisë Tatimore, dhjetor 2022

⁶ Martini, Máira, [Vendimi i Gjykatës së BE-së për regjistrat e pronësisë reale: Një vit më pas, nevoja për një qasje të harmonizuar është e dukshme](#), Transparency International, 22 nëntor 2023

Gjithashtu, në vendet e botës ekziston edhe një praktikë ndryshe në lidhje me transparencën, pra qasjen tek të dhënat për pronarët e vërtetë. Qasja e publikut tek të dhënat filloi të rritet ashtu siç rritej numri i vendeve që themeluan regjistra elektronikë për pronarët e vërtetë, në veçanti pas miratimit të Direktivës së Pestë të BE-së kundër Pastrimit të Parave.

Përveç kësaj, gjatë krizës së COVID-19, disa nga vendet që përdorën mjete financiare nga Fondi Monetar Ndërkombëtar e përbushën detyrimin e tyre për publikimin e emrave të pronarëve të vërtetë të kompanive që kanë fituar kontrata për prokurime publike.

Aktualisht, në botë po bëhen përpjekje të përditshme për t'i përshpejtuar reformat në drejtim të përmirësimit të transparencës për pronësinë e vërtetë të kompanive. Në këto suaza theksohet nevoja për të vendosur synime më ambicioze.

Sot më nuk flitet më për diçka që nënkuptohet – se regjistrat për pronarët e vërtetë duhet të jenë transparentë dhe të dhënat për gjithçka të jenë të aksesshme për të gjithë. Diskutimet tani përqendrohen në rezultatet nga qasja tek të dhënat për pronarët e vërtetë, përkatësisht përdorimi i këtyre të dhënave për të zbuluar korrupsionin dhe për zbatimin konsequent të ligjeve, gjëra nga të cilat në fund përfitojnë të gjithë qytetarët dhe mbarë ekonomia.

Kështu, vetëm kohët e fundit, rëndësia që të dhënat për pronarët e vërtetë të mos mbeten vetëm në letër dhe në disa regjistra, por të bëhen publike dhe të përdoren në mënyrë interoperative për veprime specifike në luftën kundër korrupsionit, nga aspekte të ndryshme, është theksuar në suazat e Samitit për Demokraci, në rezolutat dhe diskutimet e Konferencave të shteteve anëtare të UNCAC, në Direktivën e BE-së për parandalimin e pastrimit të parave, si dhe në Planet e Veprimit për Partneritetin për Qeverisje të Hapur të pothuajse 40 vendeve nga e gjithë bota.

Rezoluta 9/7⁷, e miratuar në dhjetor 2021, në Konferencën e nëntë të Shteteve Anëtare të UNCAC, u bën thirrje Shteteve Anëtare të grumbullojnë informacione të përditësuara për pronarët e vërtetë dhe të sigurojnë qasje efikase për institucionet kompetente tek ato informacione, përfshirë edhe ato për prokurime publike.

Kërkesa e Shteteve Anëtare për përdorim më efikas të informacioneve për pronarët e vërtetë është theksuar edhe nga një rezolutë tjetër 10/6⁸ nga Konferenca e fundit e Shteteve Anëtare të UNCAC në dhjetor 2023.

Mbretëria e Bashkuar ishte ndër vendet e para në botë që publikoi një regjistër për pronarë të vërtetë, në dispozicion për publikun, para çdo vendi tjetër në Evropë. Regjistri është i aksesshëm në internet⁹, çdokush mund ta përdorë atë falas dhe i njëjti përmban mundësinë për të bërë kërkime. Vetëm gjatë vitit të parë kur u bë e mundur një qasje e tillë, në vitin 2018, regjistri është vizituar më shumë se gjashtë miliardë herë. Vlerësohet se përfitimi i përgjithshëm nga korrigjimet e shumta të informacioneve që i kanë bërë kompanitë, ndërkaq të cilat kanë vijuar sipas sugjerimeve nga vizitorët e regjistrat, para se gjithash qytetarë dhe organizata civile, arrin shumën prej një deri në tre miliardë paund britanik në nivel vjetor.

Një tjetër shtet që ka shkuar më larg në përdorimin e të dhënave për pronësinë reale për të luftuar korrupsionin është Sllovakia, një vend anëtar i BE-së. Secila kompani, e cila në çfarëdo mënyre ka të themeluar marrëdhënie, punon ose bashkëpunon me sektorin publik, qoftë përmes prokurimeve publike ose përdor grante, dotacione, subvencione, leje ose licenca për punë, ose punon me sektorin e shëndetësisë publike, në bazën e posaçme të të dhënave, e cila është në dispozicion për publikun, duhet paraprakisht të ketë parashtruar të dhëna për pronarët e vërtetë. Dënimet për kompanitë nëse nuk dorëzojnë të dhëna ndërkaq bëjnë raporte biznesi me shtetin mund të shkojnë deri në tre vjet ndalim për pjesëmarrje në tenderë dhe gjobë deri në 1 milion euro.

⁷ <https://www.unodc.org/corruption/en/cosp/conference/session9-resolutions.html#Res.9-7>

⁸ [2325375F_L10_Rev1.pdf](#)

⁹ <https://find-and-update.company-information.service.gov.uk/>

Slovakia ka ndërmarrë edhe masa për të parandaluar shmangien e limitit për paraqitjen e pronarëve të vërtetë duke i shtuar aspektet e “kontrollit të përbashkët” dhe “veprimit të koordinuar” në kriteret. Kjo donë të thotë që, megjithëse dikush nuk konsiderohet si pronar i vërtetë bazuar në limitin e pronësisë individuale, megjithatë mund të “kualifikohet” së bashku me ndonjë person ose persona të tjerë nëse supozohet kontroll i përbashkët ose veprim i koordinuar i tyre, si për shembull, kur personat janë anëtarë të së njëjtës familje ose kur aksionarë të ndryshëm paraqesin histori të ngjashme ose të njëjtë votimi.

Edhe në Gjeorgji, publiku ka qasje te regjistri në internet për pronarët e vërtetë¹⁰, me mundësinë për të bërë kërkime dhe regjistri është i lidhur me baza të tjera të dhënash siç janë për prokurimet publike, donacionet e partive politike dhe deklaratat e interesit të funksionarëve.

¹⁰ https://enreg.reestri.gov.ge/main.php?m=new_index

Themelimi i një regjistri për pronarët e vërtetë në vendin tonë

Në vendin tonë, kuadri ligjor për zbulimin e emrave të pronarëve të vërtetë duke i regjistruar ata në një Regjistër të posaçëm për pronarët e vërtetë është paraparë në “ligjin për parandalimin e pastrimit të parave dhe financimit të terrorizmit”¹¹ nga qershori i vitit 2018 dhe aktin nënligjor përkatës për themelimin e regjistrit nga tetori i vitit 2018, edhe pse shprehja “pronar i vërtetë” për herë të parë u instalua në tekstin e “ligjit për parandalimin e pastrimit të parave dhe financimit të terrorizmit”¹² nga shtatori i vitit 2014, megjithatë, “regjistri për pronarët e vërtetë” është themeluar vetëm në bazë të ligjit të vitit 2018.

Regjistri për pronarët e vërtetë është lëshuar në përdorim më 27 janar 2021 dhe të dhënat nga ai janë bërë të aksesshme nga 27 prilli 2021 e tutje.

Në korrik 2022, është miratuar tekst i ri i “Ligjit për Parandalimin e Pastrimit të Parave dhe Financimit të Terrorizmit”¹³, por përkufizimi për pronar të vërtetë mbetet i njëjtë me atë që është përcaktuar në tekstin e mëparshëm ligjor nga viti 2018. Sipas nenit 2 të ligjit aktual, “pronari i vërtetë” është çdo person fizik që është pronari faktik i klientit ose e kontrollon klientin dhe/ose personin fizik në emër dhe në llogarinë e të cilit bëhet ndonjë transaksion. Kjo shprehje gjithashtu përfshin një apo më tepër persona fizik që ka KONTROLL FAKTIK dhe efektiv mbi NDONJË PERSON JURIDIK OSE PERSON JURIDIK TË HUAJ.

Në të njëjtin nen të ligjit përcaktohet se “regjistri për pronarët e vërtetë” është një sistem informacioni që mundëson në formë elektronike të merren, evidentohen, përpunohen, ruhen dhe shkëmbehen të dhënat dhe/ose dokumentet për pronarët e vërtetë.

Në nenin 20, ligji përcakton që pronari i vërtetë i një personi juridik është “person(at) fizik(ë), i cili faktikisht zotëron ose ka kontroll mbi personin juridik përmes pronësisë së drejtpërdrejtë dhe/ose të tërthortë mbi një përqindje të mjaftueshme të aksioneve, përkatësisht të aksioneve ose të drejtës për votë, si dhe përmes interesave tjera pronësore në atë person juridik, duke përfshirë aksionet e bartësit ose forma të tjera të kontrollit.

Pronësia e drejtpërdrejtë dhe/ose e tërthortë e personit fizik në kuptim të këtij ligji përcaktohet nëpërmjet treguesve, edhe atë:

- treguesi për pronësinë e drejtpërdrejtë, që është pronësia e më tepër se 25% të aksioneve, të drejtat e votës ose të drejtat e tjera në personin juridik ose pronësia e 25% plus një aksion dhe
- tregues për pronësinë e tërthortë, që është pronësia ose kontrolli i ndonjë personi fizik (ose më tepër personave fizikë) mbi një ose më tepër persona juridikë, të cilët individualisht ose së bashku kanë më tepër se 25% të aksioneve ose 25% plus një aksion.

¹¹ [Ligji për Parandalimin e Pastrimit të Parave dhe Financimit të Terrorizmit](#), Gazeta Zyrtare e RMV-së, numër 120, nga 29.6.2018

¹² [Ligji për Parandalimin e Pastrimit të Parave dhe Financimit të Terrorizmit](#), Gazeta Zyrtare e Republikës së Maqedonisë, numër 130, nga 3.9.2014

¹³ [Ligji për Parandalimin e Pastrimit të Parave dhe Financimit të Terrorizmit](#), Gazeta Zyrtare e RMV-së, numër 151, nga 4.7.2022

Nëse në këtë mënyrë nuk është e mundur të vërtetohet një person/a fizik/ë si pronarë të vërtetë apo nëse subjekti nuk është i sigurt që personi (personat) fizik(ë) të identifikuar sipas këtyre dispozitave janë pronarët e vërtetë, atëherë pronar i vërtetë konsiderohet “personi (personat) fizik(ë), i cili ka pozitë të lartë drejtuese në personin juridik, përkatësisht, i cili me ligj dhe aktet e brendshme është i autorizuar për ta menaxhuar dhe është përgjegjës për funksionimin e personit juridik”.

Sipas nenit 29 të ligjit, “me qëllim që të sigurohet transparencë e strukturës pronësore të personave juridikë” themelohet Regjistri për pronarët e vërtetë. Regjistrin, në formë elektronike, e themelon, udhëheq, mirëmban dhe menaxhon Regjistri Qendror i Republikës së Maqedonisë së Veriut.

Për Drejtorinë e Inteligjencës Financiare, gjykatat, autoritetet shtetërore dhe subjektet e tjera të përfshira (që janë përmendur në nenin 5, nenin 130 paragrafi (1) dhe nenin 151 paragrafi (1) të Ligjit) të dhënat nga Regjistri i kanë dispozicion pa restriksione dhe falas.

Për të gjithë personat e tjerë juridikë dhe fizikë, të dhënat nga Regjistri, në formë informacioni mund të fitohen përmes pagesës së tarifës përkatëse, sipas Tarifës së Regjistrit Qendror të RMV-së.

Neni 5 i Ligjit përcakton që subjektet që kanë detyrimin për të ndërmarrë masa dhe veprime për zbulimin dhe parandalimin e pastrimit të parave dhe financimit të terrorizmit të parashikuara me ligjin janë:

- 1) Institucionet financiare dhe njësitë rajonale, filialet dhe njësitë afariste të institucioneve financiare të huaja që në përputhje me ligjin e ushtrojnë veprimtarinë në Republikën e Maqedonisë së Veriut;
- 2) Personat juridikë dhe fizikë, të cilët si veprimtari afariste ose profesionale i ofrojnë këto shërbime:
 - a) ndërmjetësimi në shitjen e paluajtshmërive, duke përfshirë dhe/ose ndërmjetësimin gjatë nënshkrimit të kontratave për qiranë e paluajtshmërive vetëm kur vlera e qirasë mujore është 10.000 euro ose më tepër në kundërvlerë me denarin sipas kursit mesatar të Bankës Popullore të Republikës së Maqedonisë së Veriut;
 - b) shërbime auditimi dhe kontabiliteti;
 - c) dhënie e këshillave tatimore ose të çfarëdo forme të ndihmës, mbështetjes ose këshillim, drejtpërsëdrejti ose përmes ndonjë personi tjetër në fushën tatimore;
 - d) dhënie e shërbimeve si këshilltar investimesh dhe
 - e) dhënie e shërbimeve për organizimin dhe zhvillimin e ankandeve;
- 3) Noterët, avokatët dhe zyrat ligjore që ushtrojnë autorizime publike në përputhje me ligjin;
- 4) Organizatorët e lojërave të fatit të cilët në përputhje me ligjin organizojnë lojëra të fatit në Republikën e Maqedonisë së Veriut;
- 5) Ofruesit e shërbimeve të trusteve ose personave juridikë;
- 6) Depozitari Qendror i Letrave me Vlerë;
- 7) Personat juridikë që ushtrojnë veprimtarinë e marrjes së sendeve të luajtshme dhe pasurive të paluajtshme për hipotekë (dyqane pengjesh);
- 8) Personat që tregtojnë ose veprojnë si ndërmjetës në tregtimin e veprave të artit, duke përfshirë edhe kur veprimtaria kryhet nga galeritë e artit ose shtëpitë e ankandeve, ndërsa kur vlera e transaksionit individual ose e disa transaksioneve të ndërlidhura është 10.000 euro ose më tepër në kundërvlerë me denarin sipas kursit mesatar të Bankës Popullore të Republikës së Maqedonisë së Veriut;

ANALIZË

për përdorimin e të dhënave për pronarët e vërtetë në luftën kundër korrupsionit në Maqedoninë e Veriut

- 9) Personat që bëjnë magazinimin, tregti ose veprojnë si ndërmjetës në tregtimin me veprat e artit, kur veprimtaria zhvillohet në zona të lira dhe ku vlera e transaksionit individual ose të disa transaksioneve të ndërlidhura është 10.000 euro ose më tepër në kundërvlerë me denarin sipas kursit mesatar valutor të Bankës Popullore të Republikës së Maqedonisë së Veriut dhe
- 10) Dhënësit e shërbimeve në lidhje me mjetet virtuale.

Për sa u përket pronarëve të vërtetë, këto subjekte e kanë për detyrë të bëjnë “analizë mbi klientin” në rastet kur ka dyshime për vërtetësinë apo aspektin e rregullsisë së të dhënave paraprakisht të fituara për identitetin e klientit apo pronarit të vërtetë.

Analiza, në pjesën e pronarëve të vërtetë, përfshin identifikimin e pronarit të vërtetë të klientit dhe ndërmarrjen e masave të duhura për ta konfirmuar identitetin e tij, duke përdorur dokumente, të dhëna dhe informacione nga burime të besueshme dhe të pavarura, me qëllim që subjekti të jetë i sigurt se ai e di kush është pronari i vërtetë.

Nëse, pas verifikimit të pronarit të vërtetë, subjektet kanë dyshime për besueshmërinë e të dhënave të paraqitura ose për besueshmërinë e dokumenteve apo të dokumentacionit tjetër afarist, ata e kanë për detyrë që të kërkojnë deklaratë me shkrim nga përfaqësuesi ligjor me përgjegjësi të tij të plotë morale dhe materiale të vërtetuar nga një noter ose person i autorizuar prej tij para se të themelojnë marrëdhënie afarizmi ose para se kryejnë ndonjë transaksion.

Përdorimi i të dhënave për pronarët e vërtetë në parandalimin e pastrimit të parave dhe financimit të terrorizmit dhe në luftën kundër korrupsionit

Neni 130, paragrafi (1) i Ligjit për Parandalimin e Pastrimit të Parave dhe Financimit të Terrorizmit parasheh që institucionet e mëposhtme mund të paraqesin iniciativë pranë Drejtorisë së Inteligjencës Financiare (DIF), nëse konstatojnë se ka arsye për të dyshuar për pastrim të parave dhe financim të terrorizmit:

- Prokuroria Publike e Republikës së Maqedonisë së Veriut (PPRMV),
- Ministria e Punëve të Brendshme (MPB),
- Drejtoria e Policisë Financiare (DPF),
- Administrata Doganore (AD),
- Agjencia për Zbulim (AZ),
- Ministria e Mbrojtjes (MM),
- Agjencia për Siguri Nacionale (ASN) dhe
- Komisioni Shtetëror për Parandalimin e Korrupsionit (KSHPK).

Nga përgjigjet e fituara në kërkesat për qasje të lirë tek informacionet me karakter publik nga secili prej këtyre tetë institucioneve, rezulton që nga viti 2022 deri në prill të vitit 2024, vetëm katër, përkatësisht gjysma nga këto institucione kanë paraqitur një iniciativë të tillë.

Sipas përgjigjeve, nisma të tilla kanë paraqitur: Prokuroria Publike, Ministria e Punëve të Brendshme, Administrata Doganore dhe Agjencia për Siguri Nacionale.

Dy institucione (Ministria e Mbrojtjes dhe Komisioni Shtetëror për Parandalimin e Korrupsionit) janë përgjigjur se nuk kanë paraqitur iniciativë, një institucion (Drejtoria e Policisë Financiare) nuk disponon me informacione të tilla, ndërsa sa i përket institucionit të katërt (Agjencia për Zbulim), këto të dhëna janë të klasifikuara dhe për këtë arsye nuk janë publike.

Sipas të dhënave të fituara nga institucionet, deri më tani janë dorëzuar gjithsej 138 iniciativa, nga të cilat më së shumti në vitin 2023, gjithsej 75 iniciativa. Ndarazi, Prokuroria Publike ka paraqitur më së shumti iniciativa, 62 gjithsej, pas së cilës pason Agjencia për Siguri Nacionale, me 43 iniciativa.

ANALIZË

për përdorimin e të dhënave për pronarët e vërtetë në luftën kundër korrupsionit në Maqedoninë e Veriut

Iniciativa të paraqitura lidhur me dyshime për pastrim të parave dhe financim të terrorizmit

(sipas të dhënave të fituara nga institucionet)

Institucioni	2022	2023	2024 (deri në prill)	GJITHSEJ
PPRMV	28	31	3	62
ASN	10	28	5	43
MPB	9	8	4	21
AD	3	8	1	12
GJITHSEJ	50	75	13	138

Megjithatë, sipas të dhënave të fituara nga Drejtoria për Inteligjencë Financiare, rezultojnë se secili nga tetë institucionet ka dorëzuar iniciativë të tilla në këtë Drejtori. Mirëpo, numri i iniciativave për të cilat Drejtoria pohon se janë parashtruar tek ajo, përveç në rastin e Prokurorisë Publike, në asnjërin rast tjetër nuk është i njëjtë me numrin të cilin institucionet e kanë deklaruar si numër të iniciativave.

Dallimi më i madh është me Ministrinë e Punëve të Brendshme, prej nga pohojnë se ka dorëzuar 21 iniciativë të këtij lloji, ndërkah nga Drejtoria deklarohet se kjo ministri ka dorëzuar 74 iniciativë gjatë periudhës që është analizuar.

Administrata Doganore është i vetmi institucion që pohon se ka paraqitur më tepër iniciativë se sa numri që na është treguar nga Drejtoria. Nga Administrata Doganore pohojnë se kanë paraqitur 12 iniciativë, ndërsa nga Drejtoria thonë se aty janë paraqitur vetëm 4 iniciativë nga kjo doganat.

Nga Drejtoria e Policisë Financiare, prej nga thonë se nuk kanë të dhëna të tilla, në fakt janë paraqitur 7 iniciativë sipas informacioneve nga Drejtoria për Inteligjencë Financiare.

Nga Agjencia për Zbulim, e cila i ka klasifikuar këto të dhëna dhe nuk i bën publike, sipas të dhënave të Drejtorisë janë paraqitur 4 iniciativë.

Krahasimi i numrit të iniciativave të paraqitura për shkak të dyshimeve për pastrim të parave dhe financim të terrorizmit,

sipas të dhënave të fituara nga institucionet dhe të dhënave nga Drejtoria e Inteligjencës Financiare

Institucioni	2022		2023		2024 (deri në prill)		GJITHSEJ	
	Sipas institucioneve	Sipas Drejtorisë	Sipas institucioneve	Sipas Drejtorisë	Sipas institucioneve	Sipas Drejtorisë	Sipas institucioneve	Sipas Drejtorisë
PPRMV	28	28	31	31	3	3	62	62
ASN	10	7	28	24	5	7	43	38
MPB	9	34	8	35	4	5	21	74
AD	3	3	8	1	1	0	12	4
DPF	Nuk ka evidencë	5	Nuk ka evidencë	2	Nuk ka evidencë	0	/	7
BPRMV	0	1	0	0	0	0	0	1
KSHPK	0	2	0	1	0	0	0	3
AZ	Të dhëna të klasifikuara	1	Të dhëna të klasifikuara	3	Të dhëna të klasifikuara	0	/	4
MM	0	0	0	0	0	1	0	1
GJITHSEJ	50	81	75	97	13	16	138	194

Në rastet kur Drejtoria, me iniciativë të saj ose në bazë të iniciativave që i janë paraqitur, vlerëson se ekzistojnë baza të dyshimit për veprën penale pastrim i parave dhe/ose financim i terrorizmit, ajo përgatit dhe paraqet raport në Prokurorinë Themelore Publike për Ndjekje të Krimin të Organizuar dhe Korrupsionit, në përputhje me nenin 131 të Ligjit për Parandalimin e Pastrimit të Parave dhe Financimit të Terrorizmit.

Kështu, në bazë të 194 iniciativave të parashtruara nga organet kompetente, Drejtoria në vijim ka përgatitur dhe ka dorëzuar 21 raport në Prokurorinë Themelore Publike për Ndjekje të Krimin të Organizuar dhe Korrupsionit (PTHP për NKOK), përkatësisht:

- Në vitin 2022 ka dorëzuar 13 raporte dhe një plotësim raporti;
- Në vitin 2023 ka dorëzuar 7 raporte dhe një plotësim raporti dhe
- Në vitin 2024, deri në muajin prill ka dorëzuar 1 raport.

Përveç kësaj, me iniciativë vetanake, Drejtoria ka dorëzuar 50 raporte në PTHP për NKOK, për të ashtuquajturat transaksione të dyshimta, përkatësisht:

- Në vitin 2022 ka dorëzuar 31 raport dhe 13 plotësime;
- Në vitin 2023 ka dorëzuar 14 raporte dhe 6 plotësime raporti dhe
- Në vitin 2024, deri në muajin prill, ka dorëzuar 5 raporte dhe një plotësim raporti.

Përgjithësisht, rezulton se në periudhën e analizuar, 2022, 2023 dhe deri në prill të vitit 2024, Drejtoria ka dorëzuar në Prokurori gjithsej 71 raport, nga të cilat 70% janë me iniciativë vetanake dhe pjesa tjetër prej 30% me iniciativë paraprakisht të paraqitur nga ndonjë prej nëntë institucioneve të përmendura më sipër.

Drejtoria e Inteligjencës Financiare nuk ka informacione lidhur me pyetjen në sa nga raportet për dyshim për pastrim të parave dhe financim të terrorizmit kanë përfshirë të dhëna për pronarët e vërtetë. Aty është cekur se për çdo person juridik dhe person fizik nga rastet e analizës, në Regjistrin Qendror kërkohen pronarët dhe verifikohet nëse ata figurojnë në strukturat pronësore dhe drejtuese të personave juridikë.

Me kërkesë nga shtetet tjera dhe në suazat e shkëmbimit të të dhënave dhe informacioneve, Drejtoria ka siguruar të dhëna për pronarët e vërtetë lidhur me 13 kërkesa të paraqitura nga shtete tjera, përkatësisht: 2 në vitin 2022 dhe 11 në vitin 2023.

Drejtoria, nga ana tjetër, deri te shtetet tjera ka dërguar 28 kërkesa për t'i siguruar informacione për pronarët e vërtetë, edhe atë:

- Në vitin 2022 ka dërguar 15 kërkesa;
- Në vitin 2023 ka dërguar 9 kërkesa dhe
- Në vitin 2024 deri në muajin prill ka dërguar 4 kërkesa.

Gjatë tre viteve të analizuara, në nëntë raste Drejtoria ka fituar edhe informacione spontane për pronarin e vërtetë, pa i kërkuar ato informacione, edhe atë:

- Në vitin 2022, për 3 raste;
- Në vitin 2023, për 4 raste dhe
- Në vitin 2024, deri në muajin prill, për 2 raste.

Nga ana tjetër, Drejtoria gjithashtu u ka dërguar njësive të inteligjencës financiare të shteteve tjera informacione spontane për pronarët e vërtetë, edhe atë:

- Në vitin 2022 ka dërguar 6 informacione për pronarët e vërtetë;
- Në vitin 2023 ka dërguar 2 informacione dhe
- Në 2024, deri në muajin prill ka dërguar 4 informacione.

Në përputhje me nenin 75, paragrafi (3) të Ligjit, Drejtoria e Inteligjencës Financiare duhet të bashkëpunojë me këto institucione shtetërore:

- Ministrinë e Punëve të Brendshme,
- Ministrinë e Mbrojtjes,
- Ministrinë e Drejtësisë,
- Ministrinë e Punëve të Jashtme,
- Prokurorinë Publike të Republikës së Maqedonisë së Veriut,
- Agjencinë për Zbulim,
- Agjencinë për Sigurisë Nacionale,
- Drejtorinë për Policinë Financiare,
- Administratën Doganore,
- Drejtorinë e të Ardhurave Publike,
- Inspektoratin Shtetëror Devizor,
- Komisionin për Letra me Vlerë të Republikës së Maqedonisë së Veriut,
- Bankën Popullore të Republikës së Maqedonisë së Veriut,
- Agjencinë për Supervizion të Sigurimit Pensional me Financim Kapital,

- Agjencinë për Supervizion të Sigurimeve,
- Komisionin Shtetëror për Parandalimin e Korrupsionit,
- Entin Shtetëror për Auditim,
- Regjistrin Qendror i Republikës së Maqedonisë së Veriut dhe
- autoritetet dhe institucionet tjera shtetërore, si dhe me organizatat, institucionet dhe organizmat tjerë ndërkombëtarë për luftë kundër pastrimit të parave dhe financimit të terrorizmit.

Nga 17 institucionet e listuara me të cilat Drejtoria duhet të bashkëpunojë (neni 75), ndërkaq prej tyre, për tetë është cekur drejtpërsëdrejti në ligj se duhet të luftojnë kundër pastrimit të parave dhe financimit të terrorizmit (neni 130), **vetëm dy kanë shifra konkrete për rastet** për të cilat kanë përdorur të dhëna nga Regjistri për pronarët e vërtetë. Këto janë Agjencia për Sigurisë Nacionale dhe Agjencia për Supervizion të Sigurimeve.

Agjencia për Siguri Nacionale, deri më tani të dhënat i ka siguruar nga Regjistri për pronarët e vërtetë për **dy raste** që përfshijnë dy persona juridikë.

Agjencia për Supervizion të Sigurimit, deri më tani të dhënat i ka siguruar nga Regjistri për pronarët e vërtetë në **40 raste** (25 raste në vitin 2022 dhe 15 raste në vitin 2023), në të cilat të përfshirë kanë qenë 60 persona (40 persona në vitin 2022 dhe 20 persona në vitin 2023).

Inspektorati Shtetëror Devizor është përgjigjur se i përdor të dhënat nga Regjistri për pronarët e vërtetë **“në të gjitha rastet e mbikëqyrjeve të rregullta të inspektimit”** dhe **“për të gjithë personat juridikë”**, pa e cekur se për çfarë numri të rasteve dhe të personave bëhet fjalë.

Komisioni i Letrave me Vlerë u përgjigj se të dhëna të tilla përdor vetëm për **një numër të vogël personash**, por se nuk mban evidencë të përpiktë.

Shtatë institucione kanë përgjigjen se **nuk kanë pasur nevojë**, përkatësisht që deri më tani **nuk kanë përdorur të dhëna** nga Regjistri për pronarët e vërtetë (Ministria e Mbrojtjes, Drejtoria e të Ardhurave Publike, Enti Shtetit për Auditim, Ministria e Drejtësisë, Ministria e Punëve të Jashtme, Banka Popullore dhe Agjencia për Supervizion të Sigurimit Pensional me Financim Kapital).

Katër institucione **nuk mbajnë evidencë të tillë** dhe **nuk kanë informacione** për të dhënat e përdorura nga Regjistri për pronarët e vërtetë (Komisioni Shtetëror për Parandalimin e Korrupsionit, Prokuroria Publike, Ministria e Punëve të Brendshme dhe Drejtoria e Policisë Financiare).

Dy institucionet tjera nuk u përgjigjën ndaj kërkesës për informacione, njëri institucion për shkakun se ato informacione janë klasifikuara (Agjencia për Zbulim), ndërsa tjetri nuk dërgoi asnjë informacion (Administrata Doganore).

Në lidhje me pyetjet për numrin e rasteve për korrupsion dhe konflikt interesash për të cilat janë siguruar të dhëna nga Regjistri për pronarët e vërtetë dhe për pyetjen për sa persona kanë të bëjnë këto të dhëna, nga Komisioni Shtetëror për Parandalimin e Korrupsionit thonë se... **“KSHPK-ja nuk disponon me informacionet e kërkuara, përkatësisht nuk mban evidencë** për kërkime në regjistrin për pronarët e vërtetë.” Komisioni siguron të dhëna nga Regjistri për pronarët e vërtetë përmes qasjes së drejtpërdrejtë dhe deri më tani nuk ka paraqitur asnjë iniciativë pranë DIF.

ANALIZË

për përdorimin e të dhënave për pronarët e vërtetë në luftën kundër korrupsionit në Maqedoninë e Veriut

Përdorimi i të dhënave nga Regjistri për Pronarët e vërtetë për luftë kundër korrupsionit

Institucioni	Në sa raste kanë dhënë të dhëna nga Regjistri?	Për çfarë numri të personave vlejné të dhënat që janë fituar nga Regjistri?	Në çfarë mënyrë i merr të dhënat nga Regjistri?	Në sa raste kanë pasur dyshime për besueshmërinë e të dhënave?
KSHPK	Nuk mbahet evidencë	Nuk mbahet evidencë	Qasje e drejtpërdrejtë	/
PPRMV	Nuk ka asnjë informacion	Nuk ka asnjë informacion	Përmes RQM	Nuk ka asnjë informacion
MPB	Nuk mbahet evidencë	Nuk mbahet evidencë	Qasje e drejtpërdrejtë	Nuk mbahet evidencë
DPF	Nuk ka informacione në dispozicion	Nuk ka informacione në dispozicion	Qasje e drejtpërdrejtë / përmes RQM	Nuk ka informacione në dispozicion
AD	Nuk janë përgjigjur	Nuk janë përgjigjur	Nuk janë përgjigjur	Nuk janë përgjigjur
AZ	Informacione të klasifikuara	Informacione të klasifikuara	Informacione të klasifikuara	Informacione të klasifikuara
MM	Nuk është vepruar	Nuk është vepruar	Qasje e drejtpërdrejtë	Nuk është vepruar
ASN	2 raste	2 persona juridikë	Me ndërmjetësim	Nuk kanë pasur dyshim
DAP	Nuk kanë kërkuar	Nuk kanë kërkuar	Nuk kanë siguruar	Nuk kanë kërkuar
ESHA	Nuk kanë shfrytëzuar shërbime	Nuk kanë shfrytëzuar shërbime	Nuk kanë shfrytëzuar shërbime	Nuk kanë shfrytëzuar shërbime
MD	Nuk kanë shfrytëzuar shërbime	Nuk kanë shfrytëzuar shërbime	Nuk kanë shfrytëzuar shërbime	Nuk kanë shfrytëzuar shërbime
KMK	Nuk kanë kërkuar të dhëna	Nuk kanë kërkuar të dhëna	Nuk kanë kërkuar të dhëna	Nuk kanë kërkuar të dhëna
MPJ	Nuk janë përdorur të dhëna	Nuk janë përdorur të dhëna	Nuk janë përdorur të dhëna	Nuk janë përdorur të dhëna
ISHD	Në të gjitha rastet e mbikëqyrjes së rregullt inspektuese	Për të gjithë personat juridikë nga mbikëqyrja e rregullt inspektuese	Me ndërmjetësim	Në asnjë rast
KLV	Numër i vogël/Nuk mban evidencë	Nuk mbahet evidencë	Qasje e drejtpërdrejtë	Ata nuk dyshonin deri më tani
BPRMV	Nuk përdor të dhëna	Nuk përdor të dhëna	Nuk përdor të dhëna	Nuk përdor të dhëna
ASSPFK	Nuk ka pasur nevojë	Nuk ka pasur nevojë	Nuk ka pasur nevojë	Nuk ka pasur nevojë
ASS	2022: 25, 2023: 15, 2024: asnjë	2022: 40, 2023: 20, 2024: asnjë	Qasje e drejtpërdrejtë	Nuk ka pasur ndonjë rast të tillë

Prokuroria Publike e RMV-së (PPRMV) është përgjigjur edhe në kërkesën edhe ankesën që është parashtruar dhe është marrë në konsideratë nga Agjencia për Qasje të Lirë, se... “Prokuroria Publike e Republikës së Maqedonisë së Veriut nuk i përpunon këto të dhëna përkatësisht, informacionet e kërkuara **nuk janë informacione që tashmë ekzistojnë dhe me të cilat disponon** Prokuroria Publike e Republikës së Maqedonisë së Veriut.” Kjo përgjigje ishte në lidhje me pyetjet për numrin e rasteve për të cilat janë siguruar të dhëna nga Regjistri për pronarët e vërtetë, për sa individë kanë vlejtur të dhënat që janë siguruar, në sa raste, pas vërtetimit të pronarit të vërtetë, kanë pasur dyshim për besueshmërinë e të dhënave, madje edhe për pyetjen nëse prokuroria ka qasje të drejtpërdrejtë në Regjistrin e pronarëve të vërtetë apo informacionet i siguron tërthorazi nëpërmjet parashtrimit të kërkesës në Regjistrin Qendror. Prokuroria disponon vetëm me të dhëna për iniciativat e paraqitura në DIF, edhe atë: 28 iniciativa në vitin 2022, 31 iniciativë në vitin 2023 dhe 3 iniciativa deri më 1 prill 2024.

Ministria e Punëve të Brendshme (MPB) fillimisht është përgjigjur se informacioni i kërkuar “nuk është në fushëveprimin e Ministrisë së Punëve të Brendshme” dhe ka dërguar përgjigje vetëm për numrin e iniciativave të dorëzuara në DPF, edhe atë: 9 iniciativa të paraqitura në vitin 2022, 8 në vitin 2023 dhe 4 deri në muajin prill të vitit 2024. Në shkresën e dërguar për plotësimin e përgjigjes me pyetjet tjera, përkatësisht për numrin e rasteve për të cilat janë siguruar të dhënat nga Regjistri për pronarët e vërtetë, në lidhje me sa persona kanë qenë të dhënat e siguruar, në sa raste kanë pasur dyshime për besueshmërinë e të dhënave pas verifikimit të pronarit të vërtetë, Ministria e Punëve të Brendshme është përgjigjur se ... “MPB nuk mban evidencë”, për këtë arsye nuk mund të ofrojnë evidencë të përpiktë për të dhënat e kërkuara. Nga MPB-ja thonë se punonjësit e policisë kanë qasje të drejtpërdrejtë në bazat e të dhënave të Regjistrin Qendror.

Edhe Drejtoria e Policisë Financiare (DPF) në përgjigjen e saj për të gjitha pyetjet, përveç pyetjes se çfarë qasje ka në Regjistrin për pronarët e vërtetë, është përgjigjur se “**nuk ka detyrim ligjor për të mbajtur evidencë**” për të dhënat e kërkuara dhe se bëhet fjalë “për informacione me të cilat **nuk disponon** Drejtoria e Policisë Financiare, si institucion bartës”. Përndryshe, DPF thotë se “të dhënat për pronarët e vërtetë sigurohen me **qasje të drejtpërdrejtë** nga Regjistri për pronarët e vërtetë, si dhe **përmes** Regjistrit Qendror.”

As nga ana e Administratës Doganore (AD) nuk u përgjigjën ndaj kërkesës për informacione me karakter publik për të gjitha pyetjet, përveç se për numrin e iniciativave të paraqitura në DIF, përkatësisht: 3 iniciativa të paraqitura në vitin 2023, 8 iniciativa në vitin 2023 dhe 1 iniciativë deri në prill të vitit 2024. Në pyetjet lidhur me numrin e rasteve për të cilat janë siguruar të dhëna nga Regjistri për pronarët e vërtetë, në lidhje me sa persona kanë qenë të dhënat e siguruar, në sa raste kanë pasur dyshime për besueshmërinë e të dhënave pas verifikimit të pronarit të vërtetë, si dhe nëse prokuroria ka qasje të drejtpërdrejtë në Regjistrin për pronarët e vërtetë apo informacionet i siguron tërthorazi nëpërmjet kërkesave në Regjistrin Qendror, nga Administrata Doganore kanë dhënë përgjigjen e paraqitur më poshtë, çfarëdo që të nënkuptohet me këtë: “Lidhur me sigurimin e të dhënave nga Regjistri për pronarët e vërtetë, duke qenë se me opsionet ekzistuese të kërimit të regjistrimeve në sistemin e Regjistrit Qendror, duhet të bëhen 180 ‘copy paste’ ndërveprime, së shpejti do të lëshohet një version i ri, i cili është në prodhim, me plotësim të kërimeve.”

Agjencia për Zbulim (AZ) nuk dha përgjigje për informacionet e kërkuara me arsyetimin se bëhet fjalë për “informacione/ të dhëna të klasifikuara që kanë të bëjnë me aktivitete të sigurisë-zbulimit”. Nga kjo Agjenci është dorëzuar e njëjta përgjigje edhe pas ankesës së paraqitur, me plotësimin se ka kryer edhe një test dëmi dhe për secilin nga informacionet e kërkuara kanë vlerësuar që “**paraqesin të dhëna të klasifikuara**, zbulimi i të cilave mund të shkaktojë dëme në punën e institucionit”. Kjo vlen edhe për kërkesën për përgjigje për pyetjen nëse ata kanë qasje të drejtpërdrejtë në Regjistrin për pronarët e vërtetë apo të dhënat i sigurojnë në mënyrë të tërthortë.

Ministria e Mbrojtjes (MM), në përgjigjen e saj ka thënë se në periudhën e kërkuar (vitet 2022, 2023 dhe 2024) nuk ka paraqitur nismë në DIF për sa i përket nenit 130 të Ligjit për Parandalimin e Pastrimit të Parave dhe Financimit të Terrorizmit, si dhe që ka qasje të drejtpërdrejtë në Regjistrin për pronarët e vërtetë. Në lidhje me informacione të tjera për pyetjet lidhur me numrin e rasteve për të cilat janë siguruar të dhëna nga Regjistri për pronarët e vërtetë, në lidhje me sa persona kanë qenë të dhënat e siguruar, në sa raste kanë pasur dyshime për besueshmërinë e të dhënave pas verifikimit të pronarit të vërtetë, nga Ministria e Mbrojtjes informojnë se “**nuk është vepruar në aspekt të këtyre pyetjeve**”.

Agjencia për Siguri Nacionale (ASN) është një nga dy institucionet që u përgjigjën **plotësisht me të dhëna** në të gjitha pyetjet me kërkesën për qasje të lirë. ASN-ja deri më tani ka siguruar të dhëna për dy persona juridikë nga Regjistri për pronarët e vërtetë, të cilat i ka siguruar në mënyrë të tërthortë, përmes Regjistrit Qendror. Sa i përket iniciativave të paraqitura në DIF, Agjencia ka paraqitur 10 iniciativa në vitin 2022, 28 në vitin 2023 dhe 5 iniciativa deri në prill të vitit 2024. Deri më tani, agjencia nuk ka dyshuar në besueshmërinë e të dhënave për pronarët e vërtetë nga Regjistri për pronarët e vërtetë.

Institucioni i dytë që u përgjigj me dërgimin e të dhënave specifike për pyetjet e parashtuara është Agjencia për Supervizion të Sigurimeve (ASO). Kjo agjenci ka siguruar të dhëna nga Regjistri për pronarët e vërtetë për 25 raste në vitin 2022, për 15 raste në vitin 2023 dhe deri në prill të vitit 2024 nuk ka asnjë rast të tillë. Në lidhje me personat për të cilët është dhënë informacion për pronarin e vërtetë, në vitin 2022 janë kontrolluar 40 persona, ndërsa në vitin 2023 janë kontrolluar 20 persona. Agjencia ka qasje të drejtpërdrejtë në Regjistrin për pronarët e vërtetë dhe deri më tani nuk ka pasur asnjë rast konkret të dyshimit në besueshmërinë e të dhënave të fituara nga Regjistri për pronarët e vërtetë.

Përgjigja e Drejtorisë për të Ardhurat Publike (DAP) lidhur me të gjitha informacionet e kërkuara është se “deri më tani, në Regjistrin Qendror të RMV-së **nuk kanë paraqitur asnjë kërkesë për sigurimin e të dhënave nga Regjistri për pronarët e vërtetë**”.

Enti Shtetëror i Auditimit (ESHA), për të gjitha pyetjet lidhur me të cilat janë kërkuar informacione, është përgjigjur se “Enti Shtetëror i Auditimit **nuk ka shfrytëzuar shërbime nga ky Regjistër** (përkatësisht, nga Regjistri për pronarët e vërtetë)”.

E njëjta përgjigje është dhënë edhe nga Ministria e Drejtësisë (MD), prej nga thonë se “...në vitet 2022, 2023 dhe deri në prill të vitit 2024, nuk janë përdorur shërbime nga **Regjistri për pronarët e vërtetë** as në mënyrë të drejtpërdrejtë, as nëpërmjet Regjistrat Qendror dhe nuk mund t’u japim informacion lidhur me pyetjet e paraqitura në kërkesën”.

Dhe nga Komisioni për Mbrojtjen e Konkurrencës (KMK) janë përgjigjur në të njëjtën mënyrë se ... “Komisioni i Mbrojtjes së Konkurrencës deri më tani **nuk ka kërkuar të dhëna** nga Regjistri për pronarët e vërtetë”.

Përgjigje e njëjtë na është dërguar edhe nga Ministria e Punëve të Jashtme (MPJ), pra se ministria... “nuk ka përdorur të dhëna nga Regjistri për pronarët e vërtetë”.

Inspektorati Shtetëror Devizor (ISHD) ka dërguar përgjigjen që sigurojnë të dhëna nga Regjistri për pronarët e vërtetë **për të gjithë personat juridikë dhe në të gjitha rastet** e mbikëqyrjes së rregullt inspektuese, megjithatë nuk e ka cekur se për sa prej tyre bëhet fjalë, ndonëse është paraqitur edhe ankesë për këtë përgjigje jo të plotë. Më tej, inspektorati thotë se të dhënat i siguron në mënyrë të tërthortë, përmes Regjistrat Qendror dhe se në asnjë rast nuk kanë dyshuar në besueshmërinë e të dhënave nga Regjistri për pronarët e vërtetë.

Komisioni i Letrave me Vlerë (KLV) thotë se... “për shqyrtimin e lëndëve të tij, nuk ka shumë nevojë për t’i kontrolluar të dhënat në Regjistrin për pronarët e vërtetë, ashtu që ju informojmë se **numri i rasteve për të cilat kemi kërkuar të dhëna të tilla është i vogël**”. Nga ky Komision sqarohet që në raste të caktuara dhe më komplekse, për personat juridikë ata i sigurojnë të dhënat për pronarët e vërtetë. Komisioni **nuk mban evidencë të posaçme për numrin e të dhënave të siguruar** nga Regjistri për pronarët e vërtetë, ndërsa përdor qasje të drejtpërdrejtë në këtë regjistër. Deri më tani, nuk kanë dyshuar në besueshmërinë e të dhënave për pronarët e vërtetë.

Banka Popullore e Republikës së Maqedonisë së Veriut (NBRSM) në përgjigjen e saj thekson se “**nuk i përdor dhe nuk aplikon qasje** në mënyrë të drejtpërdrejtë në Regjistrin për pronarët e vërtetë si dhe të gjitha informacionet që i merr në kuadër të ushtrimit të funksionit të saj mbikëqyrës, sipas ligjit ato nuk janë informacione me karakter publik”. Banka Popullore sqaron se bankat janë të obliguara t’i identifikojnë pronarët e vërtetë gjatë zbatimit të masave për parandalimin e pastrimit të parave dhe financimit të terrorizmit dhe nuk guxojnë të mbështeten vetëm tek të dhënat nga Regjistri për pronarët e vërtetë.

Për të gjitha pyetjet e parashtruara, Agjencia për Supervizion të Sigurimit Pensional me Financim Kapital (ASSPFK) thotë se deri më tani “**nuk ka pasur nevojë të sigurohen të dhëna** nga Regjistri për pronarët e vërtetë”.

Kërkesës së parashtruar për dërgimin e informacioneve për mënyrën se si institucioneve të përfshira u ka siguruar qasjen në Regjistrin për pronarët e vërtetë (nga neni 33, paragrafi (2) dhe (3) i Ligjit për Parandalimin e Pastrimit të Parave dhe Financimit të Terrorizmit), nga Regjistri Qendror janë përgjigjur se “ka zhvilluar sisteme dhe ka siguruar kushte teknike për qasje të drejtpërdrejtë në këtë regjistër për të gjitha autoritetet dhe subjektet kompetente nga neni 5 i ligjit në fjalë”. Qasjen e kërkuar të drejtpërdrejtë në Regjistrin për pronarët e vërtetë, Regjistri Qendror ua ka siguruar 366 autoriteteve dhe subjekteve kompetente.

Si përfundim, për shkallën e ulët apo thuajse inekzistente të përdorimit të të dhënave për pronarët e vërtetë nga institucionet flet edhe fakti që nga kërkesat për qasje të lirë tek informacionet me karakter publik, që janë parashtruar në 22 institucione, në shumicën e rasteve është kërkuar sqarim i kërkesës dhe në shtatë raste janë paraqitur ankesa në Agjencinë për Mbrojtjen e së Drejtës për Qasje të Lirë.

(Mos)zbatimi i masave të rekomanduara nga FMN-ja dhe të parashikuara në planin e veprimit për Partneritetin për Qeverisje të Hapur

Shumë vende të botës, menjëherë pas shpërthimit të pandemisë me koronavirusin, që nga fillimi i vitit 2020 iu drejtuan për ndihmë Fondit Monetar Ndërkombëtar (FMN), i cili menjëherë vuri në dispozicion fonde nga “instrumentet për financim emergjent” për t’i ndihmuar financiarisht vendet, ekonomitë e të cilave ishin më së shumti të ndikuara nga kriza. Megjithatë, për shkak të urgjencës për vënien e këtyre fondeve në dispozicion të vendeve, ndërsa në të njëjtën kohë, për shkak të rreziqeve të mëdha që ekzistonin për shpenzime të paarsyeshme dhe keqpërdorime që ndodhin në situata të tilla krize, FMN-ja vendosi kushte të kufizuara për ndarjen e fondeve. Nga qeveritë ka kërkuar që para pagesës, ato të zotohen se do të ndërmarrin politika dhe masa mbrojtëse në drejtim të transparencës dhe llogaridhënies për shpenzimet në lidhje me pandeminë, edhe atë:

- publikimin e informacioneve për kontratat për prokurime publike lidhur me pandeminë;
- publikimin e emrave të pronarëve të vërtetë të kompanive, të cilave u janë dhënë këto kontrata;
- raportimi publik për shpenzimet në lidhje me pandeminë dhe/ose
- zbatimin dhe publikimin e auditimeve mbi shpenzimet e tilla.

Secili vend është zotuar për masa të ndryshme, të cilat e kanë pasur për detyrë t’i cekin në letrën e qëllimit që ia kanë dërguar FMN-së me kërkesën për përkrahje financiare. Edhe pse Maqedonia e Veriut në letrën e saj të qëllimit¹⁴ nuk u zotua konkretisht për këto masa, megjithatë duket se në praktikë ka përmblusur tre nga katër kërkesat e FMN-së.

Në Sistemin Elektronik për Prokurime Publike, është përfshirë në mënyrë të dukshme një shenjë për prokurimet lidhur me krizën, kontratat e të cilave ishin në dispozicion të publikut. Është krijuar një ueb-faqe e posaçme me informacione për shpenzimet në lidhje me krizën, kurse Enti Shtetëror i Auditimit ka zbatuar dhe publikuar auditime për këto shpenzime.

Kërkesa e vetme që vendi nuk e ka përmblusur është publikimi i emrave të pronarëve të vërtetë të firmave, të cilave u është ndarë kontratë për prokurime publike, të paktën për prokurimet që kanë të bëjnë me përballimin e krizës COVID-19.

Në këtë drejtim, në Planin Nacional të Veprimit për Partneritetin për Qeverisje të Hapur 2021-2023¹⁵ është pranuar angazhimi i përcaktuar nga sektori civil, që në Sistemin Elektronik të Prokurimit Publik të publikohen emrat e kompanive-ofertuese dhe të kompanive që kanë fituar kontratë për prokurime publike. As ky angazhim nuk u përmblusur, por në Planin

¹⁴ Linku për letrën e qëllimit: <https://www.imf.org/en/Publications/CR/Issues/2020/04/16/Republic-of-North-Macedonia-Request-for-Purchase-Under-the-Rapid-Financing-Instrument-Press-49340>

¹⁵ Linku me zotimin: https://ovp.gov.mk/nap_proposals/%D1%98%D0%B0%D0%B2%D0%BD%D0%BE-%D0%BE%D0%B1%D1%98%D0%B0%D0%B2%D1%83%D0%B2%D0%B0%D1%9A%D0%B5-%D0%BD%D0%B0-%D0%B2%D0%B8%D1%81%D1%82%D0%B8%D0%BD%D1%81%D0%BA%D0%B8%D1%82%D0%B5-%D1%81%D0%BE%D0%BE%D1%81/

ANALIZË

për përdorimin e të dhënave për pronarët e vërtetë në luftën kundër korrupsionit në Maqedoninë e Veriut

e ri Nacional të Veprimit për Partneritetin për Qeverisje të Hapur 2024-2026, ka një angazhim të ri¹⁶ në këtë drejtim dhe i cili është i zgjeruar me një detyrim të tillë për marrëveshjet për koncesione dhe për themelimin e partneriteteve publiko-private.

Komisioni Evropian në raportin e tij¹⁷ për Maqedoninë e Veriut për vitin 2023 vlerëson se “Maqedonia e Veriut është vlerësuar si vend i harmonizuar apo i harmonizuar në shkallë të madhe me 28 nga 40 rekomandimet e FATF-së. Ndër mangësitë e identifikuara janë një numër i pakonsiderueshëm vendimesh gjyqësore në lidhje me pastrimin e parave, shqetësimet për proporcionalitetin, efektin e mospërsëritjes dhe efektivitetin e sanksioneve monetare, cilësinë e të dhënave në regjistrin për pronarët e vërtetë, mungesën e sanksioneve për mospërputhshmëri në lidhje me informacionin për pronësinë bazë apo të vërtetë, mangësitë teknike për konfiskim, mungesa për një qasje sistematike për kryerjen e hetimit financiar dhe një numër i vogël raportesh për transaksione të dyshimta në krahasim me shkallën e rrezikut, kontekstin dhe madhësinë e vendit.”

Edhe OSBE¹⁸ në profilin e fundit për vendin, vlerëson se “regjistrin për pronarët e vërtetë i Maqedonisë së Veriut, i krijuar në vitin 2021, i mungon zbatimi dhe verifikimi dhe me këtë rrezikon rritjen e pastrimit të parave dhe aktiviteteve informale ekonomike”.

¹⁶ Linku për zotimin: https://ovp.gov.mk/nap_proposals/1-2-%D1%98%D0%B0%D0%B2%D0%BD%D0%BE-%D0%BE%D0%B1%D1%98%D0%B0%D0%B2%D1%83%D0%B2%D0%B0%D1%9A%D0%B5-%D0%BD%D0%B0-%D0%B8%D0%BC%D0%B8%D1%9A%D0%B0%D1%82%D0%B0-%D0%BD%D0%B0-%D0%B2%D0%B8%D1%81%D1%82%D0%B8/

¹⁷ https://neighbourhood-enlargement.ec.europa.eu/system/files/2023-11/SWD_2023_693%20North%20Macedonia%20report.pdf

¹⁸ https://www.oecd.org/content/dam/oecd/en/events/2024/10/grc_north-macedonia/MKD-Key-findings-ppt.pdf

Rekomandimet

Duke marrë parasysh të gjitha aspektet e përpunuara në analizë, ndërkaq të cilat kanë të bëjnë me praktikën botërore të publikimit të emrave të pronarëve të vërtetë, nëpërmjet themelimit dhe përdorimit të regjistrave me të dhëna të këtilla, si dhe në drejtim të parandalimit, zbulimit dhe sanksionimit të pastrimit të parave, financimit të terrorizmit, korrupsionit dhe formave tjera të keqpërdorimeve me fondet publike, janë përgatitur rekomandimet e mëposhtme që duhet të merren parasysh në përmirësimin e situatës në Maqedoninë e Veriut.

Në përgjithësi, duhet:

- Të mundësohet qasje adekuate (palë të ndryshme të interesuara të kenë qasje në nivele dhe vëllime të ndryshme të informacioneve të regjistrat¹⁹), funksionalitete dhe cilësi e informacioneve në mënyrë që të dhënat për pronarët e vërtetë të përdoren në mënyrë proaktive nga një gamë sa më e gjerë e palëve të interesuara, sikur revizorët, gazetarët, organizatat e shoqërisë qytetare, sektori privat, etj. Për shembull, auditimi mund të përdorë të dhënat për të zbuluar lidhje të fshehta dhe marrëveshje jotransparente ndërmjet firmave në prokurimet publike; organizatat e shoqërisë qytetare dhe mediat, gjithashtu të zbulojnë pronësinë e fshehtë të zyrtarëve në kompanitë që fitojnë kontrata me shtetin; ndërsa sektori afarist ta zvogëlojë rrezikun dhe të jetë në dije se me kë bashkëpunon.
- Të zgjerohet përfshirja e informacioneve për pronarët e vërtetë, duke e përcaktuar një limit më të ulët të pronësisë individuale nga përqindja aktuale prej 25%, nëpërmjet përfshirjes grupore të personave të përfshirë, etj.
- Të zgjerohet ndërveprimi për përdorimin e të dhënave për pronarët e vërtetë me qëllim të parandalimit, zbulimit dhe sanksionimit të korrupsionit dhe abuzimeve, jo vetëm në lidhje me pastrimin e parave, financimin e terrorizmit dhe financimin e paligjshëm, por edhe në fusha të tjera, si prokurimet publike, subvencionet, ndihma shtetërore, koncesionet, pagesa e taksave, donacionet partiake, financimi i fushatave politike, etj.
- Të lidhen të dhënat nga Regjistri për pronarët e vërtetë me regjistrat dhe bazat e tjera të të dhënave siç është Sistemi Elektronik për Prokurime Publike, koncesionet, partneritet publiko-privat, kadastra, thesari, doganat, ndihma shtetërore, lejet dhe licencat e lëshuara, personat e zgjedhur dhe të emëruar, deklarimi i interesave dhe gjendjes pasurore, etj.
- Të përmirësohet verifikimi i të dhënave, përgjegjësia dhe të mundësohet monitorimi (nëpërmjet opsionit që të dhënat të jenë në dispozicion dhe falas për publikun, me çka do të mundësohet raportimi i parregullsive nga qytetarët, organizatat e shoqërisë qytetare, gazetarët, subjektet afariste, etj., korrigjimi i të dhënave dhe si rrjedhojë edhe rritje e përgjegjësisë).

Të gjitha këto rekomandime do të shtjellohen në mënyrë më të detajuar në një dokument të posaçëm për politikat publike.

¹⁹ Fernando, Francisca, Richard Berkhout, [Demaskimi i kontrollit: Një udhëzues për transparencën e pronësisë së vërtetë](#), FMN, 7 tetor 2022 (fq. 48)

Linqet për materialet dhe literaturën referente

- van der Does de Willebois, Emile, Emily M. Halter Robert A. Harrison Ji Won Park JC Sharman, *Mjeshtrit e Kukullave, Si i përdorin të korrumpuarit strukturat ligjore për të fshehur pasuritë e vjedhura dhe çfarë duhet bërë për këtë*, Banka Botërore, 2011 (<https://star.worldbank.org/sites/star/files/puppetmastersv1.pdf>)
- Gagovski, Borjan, *Transparenca duke u mbajtur për fije: Një rrugë e vështirë deri në publikimin e plotë të pronarëve të vërtetë të firmave që fitojnë tenderë*, Meta, 8 qershor 2023 (<https://meta.mk/transparentnost-na-konec-tezhok-pat-do-celosno-objavuvanje-na-vistinskite-sopstvenici-na-firmi-koi-dobivaat-tenderi/>)
- Komisioni Evropian, *dokumenti i punës së personelit të Komisionit, Raporti për Maqedoninë e Veriut 2023*, Bruksel, 8.11.2023 (https://neighbourhood-enlargement.ec.europa.eu/system/files/2023-11/SWD_2023_693%20North%20Macedonia%20report.pdf)
- Janev, Aleksandar, Mladen Obrenović, *Pronarët e vërtetë të kompanive u zbuluan, por edhe ata mund të jenë të rremë: Ekziston mundësia që të dhënat për pronarët e vërtetë të jenë të rreme ose jo të plota*, Prisma, 9 nëntor 2021 (<https://prisma.mk/se-otkrija-vistinskite-gazdi-na-firmite-no-i-tie-mozhe-da-se-lazhni/>)
- Knobel, Andres dhe Florencia Lorenzo, *Regjistrimi i pronësisë së vërtetë në mbarë botën 2022*, Rrjeti i Drejtësisë Tatimore, Dhjetor 2022 ([State-of-Play-of-Beneficial-Ownership-2022-Tax-Justice-Network.pdf](https://www.oecd.org/content/dam/oecd/en/events/2022/10/grc_north-macedonia/MKD-Key-findings-ppt.pdf))
- Martini, Maira, *Vendimi i Gjykatës së BE-së për regjistrat e pronësisë së vërtetë: Një vit më vonë, nevoja për qasje të harmonizuar është e dukshme*, Transparency International, 22 nëntor 2023 ([Vendimi i gjykatës së BE-së për regjistrat e pronësisë përfituese:.... - Transparency.org](https://www.transparency.org/en/press-releases/2023/11/22/decision-of-the-eu-court-on-beneficial-ownership-registration-a-year-later-the-need-for-harmonised-access-is-clear))
- Plani Nacional i Veprimit për Partneritetin për Qeverisje të Hapur 2021–2023* (<https://ovp.gov.mk/wp-content/uploads/2021/07/NAP5-PARTNERSTVO-ZA-OTVORENA-VLAST-2021-2023--potvrden-od-Vlada-26.10.2021.pdf>)
- Plani Nacional i Veprimit për Partneritetin për Qeverisje të Hapur 2024–2026* (<https://ovp.gov.mk/wp-content/uploads/2024/05/%D0%9D%D0%90%D0%9F-%D0%9F%D0%9E%D0%92-2024-2026-%D1%84%D0%B8%D0%BD%D0%B0%D0%BB.docx>)
- OSBE, *Perspektiva e Konkurrencës në Ballkanin Perëndimor 2024, Profili i Maqedonisë së Veriut*, 3 tetor 2024 (https://www.oecd.org/content/dam/oecd/en/events/2024/10/grc_north-macedonia/MKD-Key-findings-ppt.pdf)
- Okunbor, Eva, Tymon Kiepe, *Të dhënat për pronësinë e vërtetë në prokurimet, Pronësia e hapur*, Mars 2021 ([oo-briefing-bo-data-in-procurement-2021-03.pdf](https://www.oecd.org/content/dam/oecd/en/events/2021/03/grc_north-macedonia/MKD-Key-findings-ppt.pdf))
- Orduna, Maria Constanza Castro, Adriana Fraiha Granjo, *Aplikimet dhe ndikimi i informacioneve për pronësinë e vërtetë*, Përgjigjja e U4 Helpdesk, 25 mars 2023 ([The-uses-and-impact-of-beneficial-ownership-information_2023.pdf](https://www.u4helpdesk.org/publications-reports/the-uses-and-impact-of-beneficial-ownership-information-2023.pdf))
- Stojanovski, Vlatko, *Shefat e 408 kompanive "fshehen" në 28 vende 'offshore'*, Qendra për Zhvillimin e Mediave të Komuniteteve "Medium", 5 janar 2021 (<https://mediumcenter.mk/wp-content/uploads/2021/01/%D0%93%D0%90%D0%97%D0%94%D0%98%D0%A2%D0%95-%D0%9D%D0%90-408-%D0%9A%D0%9E%D0%9C%D0%9F%D0%90%D0%9D%D0%98%D0%98-%D0%A1%D0%95->)
- UNODC, *Përmirësimi i përdorimit të informacioneve për pronësinë e vërtetë për të forcuar rikuperimin e aseteve*, Konferenca e Shteteve Nënshkruese të Konventës së Kombeve të Bashkuara kundër Korrupsionit, sesioni i dhjetë Atlanta, Shtetet e Bashkuara të Amerikës, 11–15 dhjetor 2023 ([2325375E_L10_Rev.1.pdf](https://www.unodc.org/corruption/en/cosp/conference/session9-resolutions.html#Res.9-7))
- UNODC, *Rezoluta 9/7, Përmirësimi i përdorimit të informacioneve për pronësinë e vërtetë për të lehtësuar identifikimin, rikuperimin dhe kthimin e pasurimeve nga krimi*, Konferenca e Shteteve Nënshkruese të Konventës së Kombeve të Bashkuara kundër Korrupsionit, Sharm el-Sheikh, Egjipt, 13–17 dhjetor 2021 (<https://www.unodc.org/corruption/en/cosp/conference/session9-resolutions.html#Res.9-7>)
- Fernando, Francisca, Richard Berkhout, *Demaskimi i kontrollit: Një udhëzues për transparencën e pronësisë së vërtetë*, FMN, 7 tetor 2022 ([Demaskimi i kontrollit: Një udhëzues për transparencën e pronësisë së vërtetë | Biblioteka elektronike e FMN-së](https://www.fatf-gafi.org/content/dam/fatf-gafi/fsrb-mer/N-Macedonia-Moneyval-Mutual-Evaluation-2023.pdf.coredownload.inline.pdf))
- Këshilli i Evropës, *Masat kundër pastrimit të parave dhe financimit të terrorizmit Maqedonia e Veriut, Raporti i Vlerësimit të ndërsjellë të Raundit të Pestë*, maj 2023 (<https://www.fatf-gafi.org/content/dam/fatf-gafi/fsrb-mer/N-Macedonia-Moneyval-Mutual-Evaluation-2023.pdf.coredownload.inline.pdf>)